

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Mjedisi në biznes
Niveli:	Bsc
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I-rë, Semestri II
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Caktohet nga dekanati
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc.Dr. Nagip Skenderi
Detajet kontaktuese:	nagip.skenderi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Lënda ka për objekt studimi mjedisin e jashtëm e të brendshëm në organizatat biznesore duke analizuar organizatat biznesore nga aspekti i përgjithshëm ose kontekstual, i menjëhershëm ose operativ, çasjet në organizim dhe menaxhim, Strukturat Organizative, Organizata virtuale, Aspekte të menaxhimit funksional. Gjithashtu analizohet dhe mjedisi politik e mjedisi ligjor i biznesit, duke përfshirë sistemet politike, tre funksionet e qeverisë, kontrollët dhe balancet në demokraci, klasifikimin e ligjit, burimet e ligjit, organizatat biznesore dhe ligjin, ligjin dhe konsumatorin. Një studim analitik përfshin dhe mjedisi makroekonomik me thellim tek mjedisi politik, ekonomik, teknologjik, demografik, social dhe kulturor. Poashtu, do të studiohen dhe sistemi i tregut në mjedisin biznesor, pretendentët (Stakeholders) të organizatës dhe llojet e tyre, tregjet ndërkombetare, Globalizimi dhe ndikimi i tyre në mjedisin biznesor. Dhe, krejt në fund një studim analitik do t'i kushtohet Etikës në mjedisin biznesor dhe problemeve midis bizneseve dhe grupeve të interesit nga aspekti etik.
Qëllimet e lëndës:	Përgatitja dhe aftësimi i studentëve për të kuptuar: Mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm në organizatat e biznesit, Mjedisin politik dhe Mjedisin ligjor në organizatat biznesore dhe ndikimi i tyre direkt dhe indirekt në aktivitetet e interesishme biznesore, Rolin e mjedisit makroekonomik për krijimin e një ambienti të shëndoshë biznesor. Kontekstin

	demografik, social dhe kulturor te biznesit, Pretendentët (Stakeholders) të organizatës e llojet e tyre, si dhe ndikimin që këta pretendentë kanë në organizatë, Tregjet nderkombetare dhe Globalizimi si dhe ndikimi i tyre ne mjedisin biznesor, Rolin e Etikës dhe Moralit në mjedisin biznesor etj.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	▪ <i>Të njohurit:</i> të përmbledh njohuritë teorike dhe praktike të studentëve për mjedisin e biznesit. ▪ <i>Zbatimi:</i> të përdor dituritë e fituara (teorike dhe praktike) për të punuar drejt hartimit të politikave ekonomike, sociale e politike mjedisore në funksion të zhvillimit ekonomik. ▪ <i>Analizoj:</i> vështirësitë me të cilat ballafaqohet shoqëria dhe ekonomia nga aspekti i mjedisit biznesor. ▪ <i>Sintezë:</i> të menaxhojë me vështirësitë me të cilat ballafaqohet mjedisi i biznesit i një vendi si rezultat i moshartimit të politikave adekuate sociale dhe ekonomike. ▪ <i>Vlerësimi:</i> të arsyetojë njohuritë e fituara për shoqërinë dhe ekonominë në aspektin teorik dhe praktik.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime teorike/laboratorike	1	13	13
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mesimdhënësin/konsultimet	2	10	20
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	2	1	2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	3	3
Projektet, prezantimet, etj	2	5	10
Totali			100

Metodologjia e mësimdhënies:		▪ Ligjërata, ▪ ushtrime, ▪ punë individuale, ▪ punë eksperimentale, ▪ punime seminari, ▪ kollokuime, ▪ ese, ▪ punë në terren, ▪ punë në grupe etj.
Metodat e vlerësimit:		▪ Provimi mbahet me test ▪ Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim: 10% ▪ Puna praktike dhe seminarët 20 % ▪ Testet intermediere (semestrare dhe gjysmësemestrare) (2) 30% ▪ Provimi final 40%
Literatura		
Literatura bazë:		1. Ian Worthington & Chris Britton: Mjedisi i biznesit, Vëll.1, Prishtinë, 2015, përkthyer nga Nagip Skenderi 2. Ian Worthington & Chris Britton: Mjedisi i biznesit, Vëll.2, Prishtinë, 2015, përkthyer nga Nagip Skenderi 3. Nagip Skenderi, Politikat Sociale dhe Bazat Ligjore në Kosovë, Prishtinë, 2010
Literatura shtesë:		1. Merita (Vaso) Xhumari, Proceset edhe institucionet e Politikës Sociale, Tiranë, 2003 2. Puna Sociale dhe Politika Sociale, Revistë shkencore, Tiranë, 2010
Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java	Ligjërata që do të zhvillohet	
<i>Java e parë:</i>	Njoftimi me planprogramin mësimor të lëndës dhe obligimet e dyanshme me studentët	
<i>Java e dytë:</i>	Hyrje në lëndën Mjedisi në biznes	
<i>Java e tretë:</i>	Mjedisi i jashtëm ne organizatat biznesore	
<i>Java e katërt:</i>	Mjedisi i brendshëm ne organizatat e biznesit	
<i>Java e pestë:</i>	Mjedisi politik dhe Mjedisi ligjor i biznesit	
<i>Java e gjashtë:</i>	Mjedisi makroekonomik	
<i>Java e shtatë:</i>	Testi i I-rë mes-semestral	
<i>Java e tetë:</i>	Mjedisi demografik, social dhe kulturor i biznesit	
<i>Java e nëntë:</i>	Sistemi i tregut ne Mjedisin biznesor	

<i>Java e dhjetë:</i>	Pretendentët (Stakeholders) të organizatës
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Pretendentët e brendshëm në mjedisin biznesor
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Pretendentët e jashtëm në mjedisin biznesor
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Etika në mjedisin biznesor
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Tregjet nderkombetare dhe Globalizimi dhe ndikimi i tyre në mjedisin biznesor
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi i II-të mes-semestral

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet dhe të marrin dhe librat e ushtrimeve. Studentët duhet të vijnë me kohë në mësim, të ruajnë qetësinë dhe të angazhohen aktivisht në dialog përmes shpjegimit interaktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Rekomanohet që gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve studentët të ç'kyqin telefonat celularë